



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:129470
Datë: 14.03.2024
Numri i dokumentit: 05513199

Ac.nr.9210/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Adnan Konushevci, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses E.M., nga fshati D....., Komuna Kaçanik, të cilën me autorizim e përfaqëson E.I., avokat nga Mitrovica, kundër të paditurës Policia e Kosovës, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi nga Avokatura Shtetërore N.K., në çështjen juridike për kompensim dëmi, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditëses, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.160/2019 të datës 17.08.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pathemeltë ankesa e paditëses E.M., nga fshati D....., Komuna Kaçanik, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.160/2019 të datës 17.08.2021, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.160/2019 të datës 17.08.2021, në dispozitiv e ka refuzuar të pa bazuar kërkesëpadia të paditëses, E.M., nga fshati D....., Komuna e Kaçanikut, kundër të paditurës Policia e Kosovës, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që ta kompensoj si pasojë e lëndimeve të theksuara më datë 27 shtator 2013, për shkak se kërkesa e paditëses rezulton e parashkruar.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditëses, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe shkeljes së dispozitave materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit, që aktgjykimin e atakuar ta anuloj dhe çështjen t'ia kthej në rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, ka gjetur se:

- *Ankesa është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja E.M., ka ushtruar padi, kundër të paditurës - Policia e Kosovës, përmes së cilës ka kërkuar kompensim dëmi si pasojë e lëndimit të pretenduar nga zyrtarët policor më 27.09.2013.

Duke vepruar sipas padisë së paditëses, si dhe përgjigjes në padi të ushtruar nga e paditura, gjykata e shkallës së parë ka caktuar seancën përgatitore me datë 17.08.2021, dhe pas deklarimit të palëve ndërgjyqës, e duke pas parasysh prapësimin e të paditurës e cila është thirr në parashkrim të kërkesë padisë së paditëses, ka marrë aktgjykimin C.nr.160/2019 të datës 17.08.2021, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit ankimor.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 181 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as me shkelje të tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Gjykata e Apelit, nuk mund ta pranoj si të bazuar pretendimin ankimor të paditurës se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar në mënyrë të gabuar gjendjen faktike pasi që e paditura e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë. Në rastin konkret, në bazë të shkresave të lëndës del se dëmi i pretenduar me padi si pasojë e arrestimit nga zyrtarët policor, të cilët gjatë arrestimit i kanë shkaktuar lëndime trupore paditëses, është shkaktuar me datë 27.09. 2013, ndërsa padinë paditësja në gjykatën e shkallës së parë e ka paraqitur me datë 19.02.2019, që nënkupton se padia është paraqitur pas afatit të paraparë ligjor.

Me dispozitën e nenit 357 paragrafi 1, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji Nr.04/L-77) është e përcaktuar se: *''Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin''*. Ndërsa paragrafi 2, i po të njëjtit ligj ka përcaktuar se: *''Në çdo rast kjo kërkesë parashkruhet për pesë (5) vite nga shkaktimi i dëmit''*, andaj Kolegji i kësaj gjykate vlerëson, se paditësja ka humbur çdo afat për të kërkuar shpërblimin e dëmit si pasojë e arrestimit nga zyrtarët policor, për shkak se ngjarja ka ndodhur me datë 27.09.2013 dhe deri në paraqitjen e padisë me datë 19.02.2019, kanë kaluar më tepër se pesë vite, ndaj në situatën e tillë kërkesëpadia e paditëses është e parashkruar konform dispozitave të cekura si më lartë, andaj përfundimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me refuzimin e kërkesëpadisë e pranon edhe gjykata ankimore.

Gjykata e Apelit vlerëson se e drejta materiale është aplikuar në mënyrë të drejtë nga gjykata e shkallës së parë, sepse me rastin e vendosjes për kërkesëpadsisë së paditëses, aktgjykimin e ka bazuar në dispozita konkrete ligjore që i referohen institutit të parashkrimit, e meqë e paditura me përgjigje në padi dhe në seancën përgatitore e ka theksuar prapësimin e parashkrimit, ndaj në situatën e tillë drejt ka aplikuar të drejtën materiale, kur i është referuar dispozitave të nenit 357 dhe 358 të LMD-së, andaj edhe ankesa e palës paditëse referuar këtyre dispozitave materiale-juridike është refuzuar si e pabazuar dhe është vërtetuar aktgjykimi i atakuar, duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.9210/2021, me datë 14.03.2024

Kryetare e kolegjit
Naime Ahmeti, d.v.